

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1 pika 26 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Fletorja zyrtare e MZ”, numër 2/18, 34/19 dhe 38/20), nenit 68 dhe 188 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat komunale”, numër 48/19), Kuvendi i komunës së Ulqinit në seancën e mbajtur më 27.05.2020 miratoi:

**RREGULLOREN**  
**E**  
**PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË ULQINIT**

**I DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore në pajtueshmëri me Ligjin dhe Statutin e komunës, rregullohet: procedura e konstituimit të Kuvendit të komunës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi); organizimi dhe mënyra e punës së Kuvendit; të drejtat dhe obligimet e këshilltarëve dhe mënyra e realizimit të tyre; thirrja e seancave; aktet e Kuvendit dhe procedura për sjelljen e tyre; transparenca e punës; realizimi i bashkëpunimit; mënyra dhe procedura e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave joqeveritare në punën e Kuvendit dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Kuvendit.

**Neni 2**

Çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, mënyrën dhe procedurën e punës në Kuvend, e të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, mund të rregullohen me vendim të veçantë të Kuvendit.

**Neni 3**

Shprehjet të cilat përdoren në këtë Vendim për persona në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje në gjininë femërore.

**II PËRDORIMI I GJUHËS DHE SHKRIMIT**

**Neni 4**

Në Kuvendin e komunës së Ulqinit, në përdorim zyrtarë janë të barabarta gjuha dhe shkrimi malazez dhe shqip.

Propozimet e akteve propozuesi është i obliguar t'i dorëzojë në gjuhën dhe shkrimin malazez dhe shqip.

Propozimet e akteve lëshohen në diskutim publik në të dy gjuhët.

Aktet e përgjithshme të cilat i sjellë Kuvendi shkruhen dhe publikohen në të dy gjuhët.

Shërbimi i kuvendit është i obliguar të siguroj përkthyes në të dy gjuhët.

Çdo këshilltar ka të drejtë të flas në gjuhën e tij dhe të përdorë shkrimin e vet.

### **III KONSTITUIMI I KUVENDIT**

#### **Thirrja e seancës së parë të Kuvendit të sapoformuar**

##### **Neni 5**

Seancën e parë të Kuvendit të sapoformuar e thërret kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme, më së largu në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljeve të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Thirrja për seancën e parë, këshilltarëve të sapozgjedhur u dorëzohet në afat prej 3 ditëve nga dita e dorëzimit të Raportit të Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e realizuara, kurse seanca mbahet më së largu 5 ditë nga dita e dorëzimit të thirrjes këshilltarëve.

Së bashku me thirrjen për seancën e parë, këshilltarëve u dorëzohet Raporti i Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e realizuara, Statuti i komunës, Rregullorja e punës së Kuvendit të komunës dhe Kodi etik për përfaqësuesit dhe funksionarët e zgjedhur.

##### **Neni 6**

Me seancën e parë të Kuvendit, deri në zgjedhje të kryetarit të Kuvendit, udhëheq këshilltari më i vjetër të cilit në punë i ndihmon sekretari i Kuvendit.

Në seancën e parë të Kuvendit, bëhet verifikimi i mandatit të këshilltarit dhe zgjedhja e kryetarit të Kuvendit.

#### **Verifikimi i mandatit të këshilltarit**

##### **Neni 7**

Verifikimi i mandatit të këshilltarëve bëhet në bazë të Raportit të Komisionit komunal zgjedhor.

Kryesuesi konstaton se Komisioni komunal zgjedhor ka dorëzuar Raport mbi zgjedhjet e mbajtura dhe shpallë se me dorëzimin e Raportit të Komisionit komunal zgjedhor është verifikuar dhe ka filluar mandati i këshilltarëve të sapozgjedhur.

Mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve nuk votohet.

##### **Neni 8**

Verifikimi i mandatit të këshilltarëve gjatë plotësimit të vendit të lirë të këshilltarit gjatë mandatit të Kuvendit kryhet me shpalljen e kryetarit të Kuvendit se Komisioni komunal zgjedhor ka dorëzuar Raportin mbi plotësimin e vendit të lirë të këshilltarit.

##### **Neni 9**

Të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me Ligj, Statut të Komunës dhe këtë Rregullore, këshilltari i fiton në ditën e verifikimit të mandatit.

Këshilltari merr pjesë në punën e Kuvendit në mënyrë dhe sipas procedurës të përcaktuar me këtë Rregullore.

#### **Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit**

##### **Neni 10**

Pas verifikimit të mandatit të këshilltarit, bëhet zgjedhja e kryetarit të Kuvendit.

Mënyra dhe procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe Statutit të komunës.

Kuvendi konsiderohet i konstituuar me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

#### **Neni 11**

Pas zgjedhjes, kryetari i Kuvendit jep deklaratën solemne pranë Kuvendit.

Teksti i deklaratës solemne thotë: “Solemnisht obligohem se detyrën e kryetarit të Kuvendit do ta kryejë në pajtueshmëri me Kushtetutë, ligj dhe Statut të komunës”.

Me dhënien e deklaratës solemne të kryetarit të Kuvendit merr detyrën dhe merr kryesimin e mëtejshëm të seancës së Kuvendit.

### **IV Organizimi i kuvendit**

#### **Kryetari i kuvendit**

#### **Neni 12**

Kryetari i kuvendit

- përfaqëson kuvendin;
- thërret seancën e Kuvendit, propozon rendin e ditës së seancës, kryeson dhe drejton me punën e tij;
- përkujdeset mbi organizimin dhe mënyrën e punës së Kuvendit;
- përkujdeset mbi zbatimin e Statutit të komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit;
- përkujdeset mbi realizimin e Programit të punës së Kuvendit dhe mbi atë dorëzon Raport vjetor;
- përkujdeset për punë të harmonizuar dhe në kohë, të trupave punuese të Kuvendit;
- përkujdeset mbi punën transparente të Kuvendit;
- bashkëpunon me kryetarin e komunës, organet e administratës lokale dhe shërbimet publike themelues i të cilave është komuna, në realizimin e funksionit të Kuvendit;
- nënshkruan vendime dhe akte të tjera të Kuvendit dhe përkujdeset mbi realizimin e tyre dhe
- kryen punë të tjera në pajtueshmëri me ligj, Statut dhe këtë Rregullore.

#### **Neni 13**

Në rast të pengesës së kryetarit të Kuvendit, me Kuvend kryeson nënkryetari i Kuvendit.

Në rast që Kuvendi nuk ka nënkryetar të Kuvendit kryeson këshilltari të cilin përcakton kryetari i Kuvendit.

Në rast që kryetari i Kuvendit nuk ka mundësi të përcaktojë këshilltarin që do të kryesojë me seancë të Kuvendit, me seancë kryeson këshilltari të cilin e përcakton Klubi i këshilltarëve të partisë e cila ka numrin më të madh të këshilltarëve në Kuvend.

#### **Neni 14**

Kryetarit të Kuvendit i pushon mandati para kohës në të cilin është zgjedhur në rastet e përcaktuara me Ligj.

#### **Neni 15**

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet para përfundimit të kohës në të cilën është zgjedhur, për arsytet e përcaktuara me Ligj dhe Statut të komunës.

Me seancë të Kuvendit në të cilën bëhet diskutimi mbi propozimin për shkarkim të kryetarit të Kuvendit kryeson nënkryetari i Kuvendit, ose këshilltari i caktuar si në nenin 13 të Rregullores.

Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit kryhet në mënyrë dhe sipas procedurës të përcaktuar me Statut të Komunës.

#### **Neni 16**

Në rast të dorëzimit të dorëheqjes në seancë, kryetarit të Kuvendit i pushon mandati me ditën e dorëzimit të dorëheqjes.

Kuvendi konstaton dorëheqjen në seancë në të cilën është dorëzuar dorëheqja, gjegjësisht në seancën e parë të radhës nëse dorëheqja është dorëzuar mes dy seancash.

#### **Neni 17**

Seancën e Kuvendit në të cilën konstatohet pushimi i mandatit të kryetarit të Kuvendit për shkak të dorëzimit të dorëheqjes mes dy seancave ose me fuqi të ligjit, thërret dhe me të kryeson nënkryetari i kuvendit ose këshilltari i caktuar si në nenin 13 të Rregullores.

Kuvendi pa diskutim konstaton se kryetarit të Kuvendit i ka pushuar mandati për shkak të dorëzimit të dorëheqjes dhe me fuqi të ligjit.

#### **Neni 18**

Në rast të pushimit të mandatit të kryetarit të Kuvendit para përfundimit të afatit për të cilin është zgjedhur, Kuvendi në të njëjtën gjegjësisht në seancën e radhës do të fillojë procedurën e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit, në pajtueshmëri me dispozitat e Statutit të komunës dhe këtë Rregullore dhe do të bëjë zgjedhjen më së largu në afat prej 30 ditëve nga dita e pushimit të mandatit.

### **Nënkryetari i kuvendit**

#### **Neni 19**

Nënkryetari i Kuvendit i ndihmon kryetarit të Kuvendit në kryerjen e punëve nga kompetenca e kryetarit të Kuvendit.

Nënkryetari i Kuvendit e zëvendëson kryetarin e Kuvendit në rast të pamundësisë për të kryer detyrën e tij.

#### **Neni 20**

Nënkryetari i Kuvendit mund të shkarkohet prej detyrës para përfundimit të mandatit përderisa nuk kryen punët në pajtim me Statut të komunës dhe Rregullore të punës së Kuvendit, nga arsyet e përcaktuara për shkarkim të kryetarit të Kuvendit.

Në mënyrë dhe procedurë të shkarkimit të nënkryetarit të Kuvendit zbatohen dispozitat e Statutit me të cilat rregullohet mënyra dhe procedura e shkarkimit të kryetarit të Kuvendit.

#### **Neni 21**

Në procedurën e pushimit të mandatit të nënkryetarit të Kuvendit për shkak të dorëzimit të dorëheqjes dhe me fuqi të ligjit zbatohen dispozitat e Statutit të komunës të cilat çështje janë të rregulluara edhe për kryetarin e Kuvendit.

## **Sekretari i Kuvendit**

### **Neni 22**

Kuvendi ka sekretarin të cilin e emëron Kuvendi në bazë të konkursit publik, në pajtueshmëri me Ligj dhe Statut të komunës.

Sekretari i Kuvendit organizon dhe përkujdeset për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe të tjera për Kuvend, trupa punues të tij dhe këshilltarë, si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Statut dhe vendime të Kuvendit.

### **Neni 23**

Sekretari i kuvendit:

- drejton Shërbimin e Kuvendit;
- ndihmon kryetarin e Kuvendit në përgatitjen dhe udhëheqjen e seancave;
- përkujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore, Statutit të komunës, Rregullores së punës së Kuvendit dhe akteve të tjera me të cilat rregullohet mënyra e punës së Kuvendit dhe trupave punues të tij;
- përkujdeset që vendimet dhe aktet e tjera që shqyrton Kuvendi të jenë të përgatitura në pajtueshmëri me Programin e punës së Kuvendit;
- përcjellë realizimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit;
- përkujdeset dhe është përgjegjës për hartimin e procesverbalit dhe stenogramit nga seancat e Kuvendit;
- është përgjegjës për publikimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit dhe shpërndarjen e tyre;
- përgatit kërkesën për planifikimin e mjeteve në Buxhet të komunës për nevojat e punës së Kuvendit dhe trupave punues të tij, klubeve të këshilltarëve dhe Shërbimit të Kuvendit;
- miraton pagesën e shpenzimeve në bazë të punës së Kuvendit, trupave punues, këshilltarëve dhe Shërbimit të kuvendit;
- parashtron raport kryetarit të Kuvendit dhe këshillit kompetent mbi shfrytëzimin e mjeteve
- kryen dhe punë të tjera në pajtueshmëri me Ligj, Statut, Rregullore dhe akte të Kuvendit.

### **Neni 24**

Sekretarit të kuvendit i pushon mandati nga arsyet e përcaktuara me Ligj dhe Statut të komunës.

Pushimin e mandatit të sekretarit të Kuvendit me dorëzimin e dorëheqjes ose me fuqi të ligjit, Kuvendi e konstaton në seancë.

### **Neni 25**

Sekretari i Kuvendit mund të shkarkohet prej detyrës para përfundimit të mandatit nga arsyet e përcaktuara me Ligj.

Shkarkimi i sekretarit të Kuvendit bëhet në mënyrë dhe sipas procedurës të përcaktuar me Statut të komunës.

### **Neni 26**

Në rast të pushimit të mandatit të sekretarit të Kuvendit para përfundimit të kohës në të cilën është emëruar, Kuvendi i komunës me propozim të kryetarit të Kuvendit përcakton ushtruesin e detyrës deri në emërimin e sekretarit të Kuvendit, në pajtueshmëri me ligj.

## **Klubi i këshilltarëve**

### **Neni 27**

Këshilltarët kanë të drejtë të formojnë Klubin e këshilltarëve.

Këshilltari mund të jetë anëtar i vetëm një Klubi të këshilltarëve.

Klubin e këshilltarëve e përbëjnë më së paku 2 këshilltarë.

Klubin e këshilltarëve, sipas rregullit, e përbëjnë këshilltarët e njëjës parti gjegjësisht subjekti, koalicionit të subjektit, partisë ose grupit të qytetarëve.

Nëse këshilltarët nga lista zgjedhore nuk mund të formojnë në mënyrë të pavarur një Klub këshilltarësh, mund të formojnë Klubin e këshilltarëve me këshilltarët nga lista zgjedhore tjetër ose t'i bashkëngjiten Klubit të këshilltarëve tashmë të formuar.

Mbi formimin dhe përbërjen e Klubit të këshilltarëve, kryetari i Klubit e njofton kryetarin e Kuvendit në afat prej 7 ditëve nga dita e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit.

### **Neni 28**

Klubi i këshilltarëve konstituohet në atë mënyrë që kryetarit të Kuvendit i dorëzohet lista e anëtarëve të Klubit, të cilën e nënshkruan çdo anëtar i Klubit.

Në listë veçanërisht theksohet kryetari i Klubit dhe zëvendësi i tij.

Këshilltarët e njëjës parti politike nuk mund të formojnë më shumë klube këshilltarësh.

### **Neni 29**

Klubi i këshilltarëve merr pjesë në punën e Kuvendit siç është përcaktuar me këtë Rregullore.

### **Neni 30**

Klubin e këshilltarëve e përfaqëson kryetari i Klubit.

Kryetarin e Klubit në rast të mungesës ose pengesës e zëvendëson zëvendësi i kryetarit të Klubit.

### **Neni 31**

Gjatë seancës së Kuvendit, Klubi i këshilltarëve mund të autorizojë njërin prej anëtarëve të vet të përfaqësojë Klubin e këshilltarëve në lidhje me ndonjë pikë të caktuar të rendit të ditës.

Nëse Klubin e këshilltarit e përfaqëson zëvendësi i kryetarit, ai ka të gjitha të drejtat dhe obligimet si kryetari i Klubit.

### **Neni 32**

Kryetari i Klubit të këshilltarëve në formë të shkruar e njofton kryetarin e Kuvendit mbi ndryshimin në emërtim, përbërje dhe ndryshime të tjera në Klub të këshilltarëve, në afat prej 7 ditëve nga dita e bërjes së ndryshimit.

Me rastin e qasjes së anëtarëve të rinj në Klubin e këshilltarëve, kryetari i Klubit i dorëzon kryetarit të Kuvendit deklaratat e tyre të nënshkuara mbi qasjen.

### **Neni 33**

Kuvendi i komunës është i obliguar që Klubit të këshilltarëve ti sigurojë në shfrytëzim hapësirat për nevojat e punës së Klubit.

## **Trupat punues të Kuvendit**

### **Neni 34**

Për shqyrtimin e çështjeve nga kompetencat e Kuvendit, propozimin e akteve dhe kryerjen e punëve të tjera nga kompetencat e Kuvendit, Kuvendi formon Këshilla dhe Forume, si trupa punues të përhershëm si dhe Komisione, si trupa punues të përkohshëm të Kuvendit (në tekstin e mëtejshëm: trupat punues), në përputhje me Statutin dhe Vendimin mbi formimin e trupave punues.

Përbërja dhe mënyra e punës së trupave punues përcaktohet me Vendimin mbi formimin e trupave punues të Kuvendit.

Këshilltari mund të jetë anëtarë në më se shumti 3 trupa punues.

### **Neni 35**

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të trupave punues bëhet në bazë të listës së kandidatëve.

Lista e kandidatëve përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit për kryetar dhe aq anëtarë sa zgjidhen.

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të trupit punues zgjatë sa edhe mandati i Kuvendit.

### **Neni 36**

Propozimin e listës së kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të Këshillit për zgjedhje dhe emërimë e parashtron kryetari i Kuvendit në bazë të propozimit të klubeve të këshilltarëve.

Propozimin e listës së kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të trupave të tjerë punues e parashtron Këshilli për zgjedhje dhe emërimë në bazë të propozimit të klubeve të këshilltarëve.

### **Neni 37**

Mbi propozimin e listës së kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të trupit punues Kuvendi vendos në tërësi, me votë të hapur, me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

### **Neni 38**

Nëse propozimi i listës së kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të trupit punues nuk fiton shumicën e duhur, parashtrrohet propozimi i ri i listës.

### **Neni 39**

Emërimi i kryetarit ose anëtarit individual të trupit punues me të cilin bëhet ndryshimi ose plotësimi në trupin punues kryhet në bazë të propozimeve individuale të klubeve.

### **Neni 40**

Kuvendi emëron kryetarin dhe anëtarët e organeve drejtuese të shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna, me propozim të Këshillit për zgjedhje dhe emërimë.

Propozimet për kryetar dhe anëtar i japin Klubet e këshilltarëve, proporcionalisht sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend.

Listën e njëshuar e konfirmon Këshilli për zgjedhje dhe emërimë dhe ja propozon Kuvendit për miratim.

## **Kolegjiumi i kryetarit të Kuvendit**

### **Neni 41**

Kryetari i Kuvendit formon Kolegjiumin.

Kolegjiumin e përbëjnë kryetari i Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit dhe kryetarët e klubeve të këshilltarëve.

Në punën e Kolegjiumit merr pjesë sekretari i Kuvendit.

### **Neni 42**

Kolegjiumi i kryetarit të Kuvendit:

- përcakton Planin e punës së seancës së Kuvendit;
- përcakton kohën e thirrjes dhe mbajtjes së seancës së Kuvendit dhe propozimin e rendit të ditës;
- shqyrton pyetjet mbi organizimin dhe mënyrën e punës së Kuvendit, trupave punues dhe merr masa për avancimin e procedurës së punës;
- merr pjesë në përgatitjen e Programit të punës së Kuvendit;
- përkujdeset për realizimin e punës së hapur të Kuvendit,
- kryen dhe punë të tjera në lidhje me punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij.

Mbi pyetjet nga paragrafi 1 i këtij neni Kolegjiumi i kryetarit të Kuvendit dakordohet dhe vendos në mbledhjen të cilën e cakton kryetari i Kuvendit, me iniciativë të vet ose me propozim të Klubit të këshilltarëve.

Nëse mbi çështjet e caktuara nuk arrihet pajtueshmëria, vendos kryetari i Kuvendit në pajtim me këtë Rregullore.

Mbi punën e Kolegjiumit mbahet procesverbali.

## **V TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E KËSHILLTARIT**

### **Dispozitat e përgjithshme**

### **Neni 43**

Këshilltari ka të drejtë dhe obligim të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave të tij punues dhe realizon detyrat të cilat rrjedhin në bazë të kryerjes së funksionit të këshilltarit, i propozon Kuvendit shqyrtimin e çështjeve të caktuara nga kompetenca e vetë, parashtron propozime të vendimeve dhe akteve të tjera, parashtron amendamente në propozime të dispozitave, parashtron pyetje, kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin, Statutin dhe këtë Rregullore.

### **Neni 44**

Këshilltari ka të drejtë të disponojë të gjitha materialet zyrtare dhe dokumentet të cilat janë me rëndësi për kryerjen e funksionit të këshilltarit.

Këshilltari ka të drejtë që nga ana e kryetarit të Kuvendit, sekretarit të Kuvendit, kryetarit të Komunës, eprorit të organit të administratës lokale dhe drejtuesit të shërbimit publik themelues i së cilës është Komuna, të kërkojë të dhënat të cilat i nevojiten për kryerjen e funksionit të këshilltarit.

Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni parashtrohet në formë të shkruar, kurse organi kompetent është i obliguar të japë përgjigje me shkrim në afat prej 10 ditëve.



#### **Neni 45**

Këshilltari në kryerjen e funksionit të vet ka të drejtë që nga fushëveprimi i punëve të Shërbimit të Kuvendit, të kërkoj:

- asistim profesional në hartimin e propozimeve të cilat i parashtron Kuvendit dhe trupit punues;
- dhënien e shpjegimeve profesionale mbi çështjet e caktuara lidhur me punën e Kuvendit;
- sigurimin e shfrytëzimit të materialeve të cilat janë në rend të ditës së Kuvendit ose trupit punues.

#### **Neni 46**

Këshilltari është i obliguar të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupit punues anëtarë i të cilit është dhe të vendosë.

Këshilltari ka të drejtë të marrë pjesë në punën e trupit punues të Kuvendit në të cilat nuk është anëtarë, pa të drejtë vendimmarrjeje.

#### **Neni 47**

Këshilltari nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur, mënyrën e votimit ose fjalën e folur gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltarit.

#### **Neni 48**

Këshilltari i Kuvendit ka të drejtë në kompensim për punë, në pajtueshmëri me vendimin e Kuvendit.

#### **Neni 49**

Këshilltari jep dorëheqje në formë të shkruar dhe personalisht ia dorëzon kryetarit të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit dorëheqjen e këshilltarit ja dërgon Komisionit komunal zgjedhor dhe për dorëheqjen e parashtruar e njofton Kuvendin.

Kuvendi konstaton pushimin e mandatit të këshilltarit i cili ka dhënë dorëheqje.

Këshilltarit mandati i pushon ditën e konstatimit të dorëheqjes.

#### **Pyetja e këshilltarit**

#### **Neni 50**

Këshilltari ka të drejtë të bëjë pyetje kryetarit të Kuvendit, kryetarit të komunës, kryeadministratorit, eprorit të organit të administratës lokale dhe drejtuesit të shërbimit publik themelues i të cilave është Komuna.

Pyetja e këshilltarit mund të ketë lidhje vetëm me çështjet nga kompetencat e punës së organve të vetëqeverisjes lokale, organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna.

#### **Neni 51**

Këshilltari ka të drejtë të bëjë më së shumti dy pyetje për seancë.

Pyetja e këshilltarit parashtrohet në formë të shkruar dhe i dorëzohet Shërbimit të Kuvendit më së largu 10 ditë para ditës së mbajtjes së seancës.

Pyetja e këshilltarit duhet të jetë qartë e formuluar.

Shërbimi i Kuvendit është i obliguar që pyetjen e këshilltarit, në afat prej dy ditëve, t'ia dorëzoj organit gjegjësisht shërbimit që është kompetente për dhënien e përgjigjeve.

Eprori i organit- shërbimit është i obliguar që përgjigjen në pyetje të këshilltarit në formë të shkruar t'ia dorëzoi Shërbimit të Kuvendit më së paku 3 ditë para fillimit të punës së seancës.

Shërbimi i Kuvendit është i obliguar që përgjigjen me shkrim në pyetje të këshilltarit të ja dorëzoi këshilltarit më së largu 2 ditë para fillimit të punës së seancës.

#### **Neni 52**

Përgjigjia në pyetje të këshilltarit e bërë në afat prej nenit 51 të kësaj Rregullore jepet në seancën e parë të radhës, në fillim të seancës.

Këshilltari ka të drejtë që në seancën e Kuvendit, me gojë të komunikojë përmbajtjen e pyetjes të cilën e ka parashtruar, në kohëzgjatje prej 2 minutash.

Eprori i organit jep përgjigje me gojë në pyetjen e parashtruar të këshilltarit.

#### **Neni 53**

Këshilltari që ka parashtruar pyetje, në të cilën ka fituar përgjigje ka të drejtë që në kohëzgjatje prej 3 minutash të komentojë përgjigjen dhe të parashtrojë pyetje shtesë.

Përgjigjia në pyetjen shtesë parashtrohet menjëherë me gojë ose në seancën e radhës në formë të shkruar.

Me përgjigje në pyetjen shtesë përfundon procedura e përgjigjeve në pyetje të këshilltarit.

Këshilltari nuk mund të parashtrojë pyetje të njëjtë ose të ngjajshme në të cilën tashmë është dhënë përgjigjia.

Pyetjet e këshilltarëve dhe përgjigjet publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.

#### **Neni 54**

Në rast se këshilltari nuk fiton përgjigje në pyetjen e rregullt të bërë, përkatësisht të dorëzuar, Kuvendi në atë seancë do të deklarohet dhe do të vendos për pasojat e mosrespektimit të këshilltarit, përkatësisht Kuvendit.

Qëndrimi, përkatësisht vendimi i Kuvendit nga ky nen, detyrimisht do të publikohet në faqen e internetit të Kuvendit, krahas pyetjes pa përgjigje të këshilltarit.

#### **Neni 55**

Këshilltari përmes kryetarit të komunës, gjegjësisht kryetarit të Kuvendit mund të fillojë çështje të caktuara me rëndësi për qytetarë në territorin e komunës nga kompetenca e organit të administratës shtetërore dhe shërbimeve publike, themelues i të cilave është shteti, kurse funksionin e realizojnë në territorin e komunës dhe të kërkoi informacione të caktuara dhe përgjigje në lidhje me atë pyetje.

#### **Neni 56**

Mbi punën e këshilltarit mbahet evidenca.

Evidenca nga paragrafi 1 përmban të dhënat: mbi prezencën e këshilltarëve në seancat e Kuvendit; mbi prezencën e seancave të trupave punues; mosprezencën në seancat e Kuvendit dhe trupave punues; numrin e propozimeve të vendimeve dhe iniciativave të dhëna; numrin e amendamenteve dhe iniciativave të parashtruara, numrin e pyetjeve të këshilltarëve të parashtruara; numrin e diskutimeve në seanca.

Të dhënat nga evidenca publikohen në faqen e internetit të Kuvendit, buletinin ose në mënyrë tjetër të përshtatshme më së paku një herë në vit.

Mbi mbajtjen e evidencës dhe publikimin e të dhënave përkujdeset sekretari i Kuvendit.

## **Hetimi parlamentar**

### **Neni 57**

Hetimi parlamentar mund të hapet me qëllim që të pasqyrohet gjendja në një fushë të caktuar ose të shqyrtohen pyetjet nga disa organe të interesit të përgjithshëm, mbledhjes së informatave dhe fakteve për dukuri dhe ngjarje të veçanta të lidhura me konfirmimin dhe udhëheqjen e politikës së organeve kompetente, të cilat mund të jenë bazë për vendosjen e përgjegjësisë së bartësve të funksioneve udhëheqëse.

Me qëllim të realizimit të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, Kuvendi mund të formojë këshillin anketues nga rrallët e këshilltarëve.

### **Neni 58**

Propozimin për hapjen e hetimit parlamentar dhe formimin e këshillit anketues, mund ta parashtrojnë 1/3 e këshilltarëve në Kuvend.

Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet në formë të shkruar, duhet të jetë i arsyetuar dhe posaçërisht të përmbajë: nënshkrimet e këshilltarëve, temën, qëllimin e hetimit parlamentar, detyrën, përbërjen e këshillit anketues dhe afatin për kryerjen e detyrave.

Kryetari i këshillit anketues është nga rradhët e këshilltarëve.

### **Neni 59**

Propozimi për hetim parlamentar dhe formimin e këshillit anketues propozohet për rendin e ditës së seancës së ardhshme të Kuvendit, e thirrur në pajtim me këtë rregullore.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, pas arsyetimit shtesë nga ana e përfaqësuesit të propozuesit, Kuvendi vendos pa diskutim, për propozimin në tërësi me shumicën e votave të këshilltarëve prezent.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, kryetari i Kuvendit menjëherë lajmëron prokurorinë dhe gjykatën dhe nga ato kërkon informata nëse për lëndën e njëjtë zhvillohet procedurë gjyqësore.

Nëse prokuroria dhe gjykata vërtetojnë që zhvillohet procedurë gjyqësore, kryetari i Kuvendit nuk do të veprojë si në paragrafin 1 të këtij neni, dhe vendosja për propozimin pezullohet deri në përfundimin e plotfuqishëm të rastit.

Nëse procedura gjyqësore fillon pas formimit të këshillit anketues, këshilli anketues i pezullon punimet deri në sjelljen e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës.

### **Neni 60**

Këshilli anketues ka të drejtë që me qëllim të zbatimit të hetimit parlamentar, të kërkojë nga organet shtetërore, organet e administratës lokale dhe organizata të veçanta, të dhëna, dokumenta dhe lajmërime nëse e konsideron të nevojshme.

### **Neni 61**

Pas përfundimit të hetimit parlamentar këshilli anketues i dorëzon Kuvendit Raportin i cili mund të përmbajë dhe propozimin e masave adekuate ose akteve nga kompetenca e Kuvendit.

Këshilli anketues përfundon me punën e vet ditën e vendosjes së Kuvendit për Raportin e tij, përkatësisht me përfundimin e afatit për të cilin është formuar.

## **Kartela e këshilltarit**

### **Neni 62**

Këshilltarit i lëshohet kartela e këshilltarit (në tekstin e mëtejme: kartela). Kartela është e punuar si kartë e plastifikuar, me dimensionet 85x55 milimetra.

### **Neni 63**

Kartela përmbanë:

- në anën e përparme (ballinë), në anën e majtë fotografinë e këshilltarit me përmasa 35x27 milimetra dhe emrin dhe mbiemrin e këshilltarit; në anën e djathtë tekstin: “Mali i Zi, Komuna e Ulqinit, Kuvendi i komunës”, ndërsa në gjuhën shqipe “Mali i Zi, Komuna e Ulqinit, Kuvendi i Komunës” i shkruar në tre rreshta, poshtë këtij teksti “Kartela e këshilltarit” i shkruar me shkronja të mëdha, në shqip “Kartela e këshilltarit”; në pjesën e poshtme teksti: “Numri i kartelës” dhe në shqip: “Numri i kartelës”, me vijë për shkrimin e numrit, kurse poshtë numrit tekstin: “Vlen deri më” dhe në shqip: “Vlen deri më” me vijë për shkrimin e datës;
- në pjesën e pasme të kartelës është i shkruar teksti: “Këshilltari nuk mund të ftohet në përgjegjësi për mendimin e shprehur, mënyrën e votimit ose fjalën e folur gjatë ushtrimit të funksionit të këshilltarit”, në pjesën e poshtme të librezës është teksti “Kryetari i Kuvendit të Komunës së Ulqinit”, në të dy gjuhët, emri dhe mbiemri i shtypur i kryetarit të Kuvendit, me nënshkrimin e tij;
- në mes të faqes së përparme (ballinës) dhe pjesës së pasme të kartelës është e shtypur stema e Komunës me ngjyrë;
- kartela është e ngjyrës së kaltër të çelur kurse teksti në të është i ngjyrës së zezë;
- numrat e kartelës fillojnë me numrin 1 dhe përcaktohen sipas renditjes alfabetike të mbiemrit.

### **Neni 64**

Nëse këshilltari e humbë ose në mënyrë tjetër mbetet pa kartelë, ka të drejtë që me kërkesë të vet të fitojë kartelën e re.

Kartela e re lëshohet me të njëjtin numër sikurse e mëparshmeja.

Kartela pushon së vlejuri para datës së shënuar në të, në rast se këshilltarit i pushon mandati para përfundimit të afatit për të cilën është zgjedhur.

Evidencën mbi kartelat e lëshuara e udhëheq Shërbimi i Kuvendit.

## **VI SEANCA E KUVENDIT**

### **Thirrja e seancës dhe mënyra e punës**

### **Neni 65**

Kuvendi punon dhe vendos në seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione.

Sesioni i parë fillon ditën e parë të punës së muajit mars dhe zgjatë deri në fund të korrikut, ndërsa sesioni i dytë fillon ditën e parë të punës së muajit tetor dhe zgjatë deri në fund të dhjetorit.

Seanca e jashtëzakonshme thirret me kërkesë të kryetarit të komunës ose 1/3 e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

### **Neni 66**

Seancën e Kuvendit e thërret kryetari i Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit thërret seancën e Kuvendit sipas nevojës, e më së paku njëherë në 3 muaj.

Kryetari i Kuvendit thërret seancën me iniciativën e tij, me kërkesë të Kryetarit të komunës, me kërkesë të 1/3 së këshilltarëve dhe me iniciativë të 2% të qytetarëve të regjistruar në regjistrin zgjedhor për territorin e Komunës, në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës gjegjësisht iniciativës.

Së bashku me kërkesën, gjegjësisht iniciativën për thirrjen e seancës dorëzohet edhe propozimi i rendit të ditës dhe materiali për seancë.

### **Neni 67**

Nëse kryetari i Kuvendit nuk e thërret Kuvendin, Kuvendin do ta thërras parashtruesi i kërkesës gjegjësisht iniciativës.

Nëse Kuvendin e thërret parashtruesi i kërkesës, gjegjësisht iniciativës, në përputhje me rrethanat zbatohen dispozitat të cilat kanë të bëjnë me thirrjen e seancës nga ana e kryetarit të Kuvendit.

Në rast se seancën e Kuvendit e thërret parashtruesi i kërkesës, gjegjësisht iniciativës, me seancë kryeson këshilltari të cilin e përcakton parashtruesi i kërkesës gjegjësisht iniciativës.

Seanca e Kuvendit mbahet më së largu në afat prej 15 ditëve nga dita e thirrjes.

Vendimet dhe aktet e tjera të sjella nga ana e Kuvendit, në kuptimin e paragrafit 3 të këtij neni, nënshkruhen nga kryesuesi i seancës.

### **Neni 68**

Thirrja e seancës përmban: datën, vendin e mbajtjes, orën e fillimit të punës së seancës dhe propozimin e rendit të ditës.

Thirrja për seancë i dërgohet këshilltarëve më së voni 10 ditë para mbajtjes së seancës.

Bashkëngjitur thirrjes, dorëzohet procesverbali nga seanca e kaluar dhe materiali, shqyrtimi i së cilit është planifikuar me rendin e ditës së propozuar.

Bashkëngjitur rendit të ditës mund të shkojnë vetëm propozimet e akteve të cilat janë të përgatitura në pajtueshmëri me ligj, Statut dhe këtë Rregullore.

Kuvendi nuk mund të vendosë mbi çështjet për të cilat materiali përkatës nuk u është dorëzuar këshilltarëve.

Kuvendi nuk mund të vendosë mbi çështjet për të cilat nuk ka mendimin e trupit punues kompetent, nëse me këtë Rregullore nuk është e përcaktuar ndryshe.

Përfundimisht, materiali për rendin e ditës të propozuar mund të dorëzohet brenda një periudhe më të shkurtër ose në vet seancë, me arsyetim të shkruar për atë nga ana e propozuesit.

### **Neni 69**

Përfundimisht, mbi rastet e arsyetuara të cilat kërkojnë urgjencë, kryetari i Kuvendit mund të thërras Kuvendin në afat më të shkurtër, kurse rendin e ditës ta propozoi në vetë seancë.

### **Neni 70**

Thirrja për seancë me rendin e ditës të propozuar dhe materialin për seancë u dorëzohet këshilltarëve, kryetarit të komunës, dhe nënkryetarit të komunës, në formë të shkruar ose në formë elektronike.

Thirrja për seancë i dorëzohet: kryeadministratorit, eprorëve të organeve të administratës lokale, kryetarit të Forumit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale, përfaqësuesve të qytetarëve dhe

organizatave joqeveritare të cilat marrin pjesë në punën e seancës, sipas nevojës drejtuesve të shërbimeve publike themelues i të cilave është komuna dhe medijave në formë të shkruar ose në formë elektronike.

Kryetari i Kuvendit mund të vendos që seanca dhe materiali për rendin e ditës së seancës të dorëzohet edhe subjekteve të tjera të interesuara.

Thirrja dhe materiali për seancë publikohet në faqen e internet të Kuvendit, më së largu 7 ditë para mbajtjes së seancës.

### **Neni 71**

Në rast të rrethanave të jashtëzakonshme me të cilat rrezikohet jeta dhe shëndeti i njerëzve dhe pasuria me vlerë të madhe, kryetari i Kuvendit mund të thërrasë seancën, kurse rendin e ditës ta propozoi në vet seancën.

Në rendin e ditës së seancës mund të gjenden vetëm çështjet lidhur me rrethanat e jashtëzakonshme të ndodhura.

Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes së Kuvendit, do të përcaktojë kryetari i Kuvendit në marrëveshje me kryetarin e klubeve të këshilltarëve në fillim të seancës, varësisht nga arsyeja e ftesës së seancës dhe urgjencës së sjelljes së vendimeve të përshtatshme.

### **Neni 72**

Në punën e Kuvendin mund të marrin pjesë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe qytetarët e interesuar, në mënyrë të përcaktuar me këtë Rregullore.

Organizatave joqeveritare dhe qytetarët të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në seancën e Kuvendit janë të obliguar të paraqesin pjesëmarrjen në seancë më së voni 7 ditë para mbajtjes së seancës, me obligim që të theksojnë temën për të cilën kërkojnë pjesëmarrje në seancë.

Kryetari i Kuvendit, në përputhje me mundësitë e hapësirës dhe nevojën e sigurimit të kushteve optimale për punë të seancës së Kuvendit, do të mundësojë pjesëmarrjen e subjekteve të interesuara dhe mbi atë në mënyrë adekuate do të njoftojë më së voni 3 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit.

## **RRJEDHA E SEANCËS**

### **Kuorumi për seancë**

### **Neni 73**

Kryetari i Kuvendit hap seancën e Kuvendit dhe konstaton se a janë plotësuar kushtet për punë dhe vendimmarrje do të thotë a janë prezent shumica e këshilltarëve nga numri i përgjithshëm të këshilltarëve (kuorumi).

Kuorumi përcaktohet në bazë të listës evidentuese personalisht të nënshkruar nga ana e këshilltarëve prezent ose me thirrje në kërkesë të këshilltarëve.

Thirrjen e bën sekretari i Kuvendit ose personi të cilin ai e përcakton.

Kuorumi është i domosdoshëm: për fillimin e punës së seancës, për miratimin e procesverbalit, përcaktimin e rendit të ditës dhe për vendimmarrje.

Kryetari i Kuvendit njofton se cilët këshilltarë kanë paralajmëruar gjegjësisht arsyetuar mospjesëmarrjen si dhe atë se kujt i është drejtuar ftesa për seancë.

#### **Neni 74**

Nëse kryetari i Kuvendit në fillim të seancës përcakton se nuk ekziston kuorumi për punë, e shtynë seancën dhe përcakton kohën e mbajtjes së seancës në të njëjtën ditë ose seancën e shtynë për një ditë tjetër në kohë të caktuar.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që seancën e shtyrë ta thërrasë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 7 ditë nga dita e shtyrjes.

Mbi shtyrjen e seancës dhe kohën e mbajtjes së seancës njoftohen vetëm këshilltarët të cilët nuk kanë qenë prezent në seancën e cila është shtyrë.

#### **Neni 75**

Nëse gjatë seancës kryetari i Kuvendit konstaton se nuk ekziston kuorumi për vendimmarrje e ndërpret seancën përderisa mos të sigurohet kuorumi dhe përcakton kohën e vazhdimit të seancës.

Nëse seanca shtyhet për një kohë të pacaktuar, kryetari i Kuvendit thërret kryetarët e klubeve të këshilltarëve në afat prej 3 ditëve nga dita e shtyrjes, në mënyrë që të caktojë kohën e vazhdimit të seancës, e cila duhet të vazhdojë në afat prej 7 ditëve nga dita e shtyrjes.

#### **Miratimi i procesverbalit**

#### **Neni 76**

Para përcaktimit të rendit të ditës për seancë miratohet procesverbalin nga seanca e kaluar.

Këshilltari mund të bëjë vërejtje në procesverbal dhe të kërkojë që në të të bëhen ndryshimet dhe plotësimet përkatëse.

Sekretari i Kuvendit jep qëndrimin e vet mbi vërejtjet e dhëna në procesverbal.

Mbi bazueshmërinë e vërejtjeve në procesverbal Kuvendi vendos pa diskutime.

Kryetari i Kuvendit e qet procesverbalin në votim dhe shpallë se procesverbalin është miratuar pa vërejtje, gjegjësisht me ndryshime dhe plotësime të cilat janë pranuar dhe konstaton se janë plotësuar kushtet për vërtetimin e tij.

#### **Përcaktimi i rendit të ditës**

#### **Neni 77**

Kryetari i Kuvendit jep shpjegimet e duhura në lidhje me rendin e ditës të propozuar.

Kryetari i Kuvendit, kryetari i komunës, këshilltari dhe trupi punues i përhershëm i Kuvendit, mund të propozojnë ndryshimet e rendit të ditës, me arsyetim të shkurtër të propozimit.

Propozimet për ndryshimin e rendit të ditës janë: tërheqja e pikave të caktuara nga rendi i ditës së propozuar dhe plotësimi i rendit të ditës me pika të reja.

Në diskutim mbi ndryshimet e propozuara të rendit të ditës mund të marrin pjesë vetëm propozuesi për ndryshimin e rendit të ditës, gjegjësisht përfaqësuesi i tij dhe propozuesi, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit të aktit për shkak të së cilit propozohet ndryshimi i rendit të ditës, kurse pjesëmarrja në diskutim mund të zgjasë më së shumti 3 minuta.

Propozimet për tërheqjen e akteve të caktuara nga rendi i ditës i dorëzohen kryetarit të Kuvendit në formë të shkruar deri në fillimin e mbajtjes së seancës ose me gojë në vet seancë.

Propozimet për plotësimin e rendit të ditës me propozim aktin, i dorëzohen kryetarit të Kuvendit më së largu 3 ditë para mbajtjes së seancës.

Propozim akti nga paragrafi paraprak u dorëzohet këshilltarëve dhe kryetarit të komunës, përderisa ai nuk është propozuesi.

#### **Neni 78**

Kuvendi vendos veçmas mbi çdo propozim për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës dhe ata së pari mbi propozimet që ndonjë pikë e caktuar të hiqet nga rendi i ditës pastaj mbi propozimet për plotësimin e rendit të ditës.

Pikat e reja vendosen në rendin e ditës sipas renditjes të përcaktuara nga ana e kryetarit të Kuvendit, pa diskutim.

#### **Neni 79**

Në rast se trupi punues kompetent propozon që propozim vendimi i caktuar ose akti tjetër të mos radhitet në rendin e ditës për shkak të mos ekzistimit të bazës juridike për sjelljen e tij, Kuvendi vendosë, pa diskutim.

#### **Neni 80**

Mbi propozimin e rendit të ditës në tërësi Kuvendi vendos pa diskutim, me shumicën e votave të këshilltarëve prezent.

Kryetari i Kuvendit shpallë rendin e ditës së seancës.

Pasi që kryetari i Kuvendit të shpallë rendin e miratuar të ditës, kalohet në diskutime sipas radhitjes së përcaktuar nga rendi i ditës.

Kryetari i Kuvendit, gjatë zgjatjes së seancës, për shkak të punës më efektive dhe më racionale mund të propozoi ndryshime në radhitjen e diskutimeve ose unifikimin e diskutimeve mbi çështjet e caktuara, mbi të cilën vendosë Kuvendi.

#### **Pjesëmarrja në diskutim**

#### **Neni 81**

Në seancë të Kuvendit askush nuk mund të flasë para se të kërkojë dhe të marrë fjalën nga ana e kryetarit të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit këshilltarit dhe pjesëmarrësve të tjerë në seancë u jep fjalën sipas radhitjes së paraqitjes.

#### **Neni 82**

Propozuesi, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit mundet në fillim të diskutimit mbi propozimin e aktit të japë arsyetimin hyrës, në kohëzgjatje prej 10 minutash, gjatë diskutimit të japë përgjigje në pyetjet e shtruara më së gjati deri në 3 minuta për një pyetje, dhe me mbarim të diskutimit ka të drejtë në fjalën përfundimtare.

Pas propozuesit, gjegjësisht përfaqësuesit të propozuesit në diskutim sipas radhitjes në vijim mund të marrin pjesë: raportuesi në emër të trupit punues i cili ka shqyrtuar pyetjen mbi të cilën hapet diskutimi; këshilltari i cili në trupin punues ka dhënë mendim; kryetari i komunës, përderisa nuk është propozues, pastaj fjalën e marrin këshilltarët sipas radhitjes së paraqitjes.

Në diskutim mund të marrin pjesë kryetari, gjegjësisht anëtari i Forumit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale, si dhe përfaqësuesi i qytetarëve të interesuar dhe organizatave joqeveritare.



Raportuesi, në emër të trupit punues dhe propozuesi, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit, gjatë diskutimi mund të flasin më shumë herë.

### **Neni 83**

Këshilltari ose përfaqësuesi tjetër në diskutim mund të flasë vetëm mbi pyetjet që janë në rend të ditës dhe në kohëzgjatje të përcaktuar për diskutim.

Përderisa folësi del nga rendi i ditës dhe nuk i përmbahet kohës së përcaktuar për diskutim, kryetari i Kuvendit mbi këtë do ti tërheq vërejtjen.

Përderisa folësi as pas vërejtjes së tërhequr nuk i përmbahet rendit të ditës ose kohës për diskutim, kryetari i Kuvendit do t'ia ndalë mikrofonin (do t'ia marrë fjalën) dhe do ta ftojë të paraqiturin e radhës ta marrë fjalën për diskutim.

### **Neni 84**

Kryetari i Kuvendit mund të ndërpresë seancën ose të shtyjë diskutimin, kur e vlerëson se për çështjen e caktuar e cila është në rend të ditës të seancës është e domosdoshme të bëhet konsultimi dhe të sigurohen mendime të caktuara.

Në rast të ndërprerjes së seancës, gjegjësisht shtyrjes së diskutimit sipas çështjeve të caktuara nga arsyet e paragrafit 1 të këtij neni, kryetari i Kuvendit thërret vazhdimin e seancës në afat prej 5 ditëve mbas konsultimeve të bëra.

### **Kohëzgjatja e të folurit**

### **Neni 85**

Të folurit e këshilltarit në diskutim mund të zgjasë më së shumti 10 minuta.

Këshilltari mbi pikën e njëjtë të rendit të ditës mund ta fitojë fjalën më së shumti dy herë.

Këshilltari në diskutim mund të fitojë fjalën për herën e dytë vetëm pasi që lista e pjesëmarrësve të cilët flasin për herë të parë të përfundoj, me atë që herën e dytë nuk mund të flasë më gjatë se 5 minuta.

Këshilltari i cili nuk e ka shfrytëzuar të drejtën në raundin e parë, ka të drejtë të marrë pjesë në diskutim në raundin e dytë në kohëzgjatje prej 5 minutash.

Kuvendi mundet, me propozim të kryetarit të Kuvendit, të vendosë pa diskutim, që mbi ndonjë pikë të caktuar të rendit të ditës të flitet vetëm një herë.

Kuvendi mundet, me propozim të kryetarit të Kuvendit, të vendosë një kohëzgjatje tjetër të të folurit, si dhe atë që mbi çështjet e caktuara të flasë vetëm numri i caktuar i përfaqësuesve të klubeve të këshilltarëve, kryetari i komunës gjegjësisht propozuesi tjetër i aktit.

### **Neni 86**

Përfaqësuesi i organizatës joqeveritare, gjegjësisht qytetarëve të cilët në seancë marrin pjesë në bazë të ftesës ka të drejtë të parashtrijë propozim ose mendim mbi pyetjen e cila është në rend të ditës për shkak të së cilës ka kërkuar pjesëmarrje në seancë, me atë që të folurit e tij mund të zgjasë deri në 15 minuta, pa të drejt vendimmarrjeje (Instituti “karrige e lirë”).

## **Shkelja e Rregullores**

### **Neni 87**

Këshilltarit i cili kërkon të flasë mbi shkeljen e Rregullores, kryetari i Kuvendit i jep fjalën në momentin që ai e kërkon, me atë që këshilltari është i obliguar të tregoi në dispozitën e Rregullores për të cilën konsideron se është shkelur, ndërsa të folurit e tij nuk mund të zgjasë më gjatë se 3 minuta.

Kryetari i Kuvendit, këshilltarit i jep shpjegime me rastin e vërejtjeve të theksuara, në lidhje me shkeljen e Rregullores.

Nëse këshilltari nuk është i kënaqur me shpjegimet e dhëna dhe kërkon deklarinimin e Kuvendit për shkeljen e Rregullores, kryetari i Kuvendit, pa diskutim, fton këshilltarët që të deklarohen për ekzistimin e shkeljes së Rregullores.

## **Replika**

### **Neni 88**

Këshilltari emri apo personaliteti i të cilit është përmendur drejtpërdrejt në kontekst negativ ose gabimisht është interpretuar deklarimi i tij, ka të drejtë të kërkojë fjalën (të drejtë në replikë). Kryetari i Kuvendit atij këshilltari ia jep fjalën kur ai ta kërkojë.

Të drejtë nga paragrafi 1 i këtij neni ka kryetari i klubit gjegjësisht përfaqësuesi i autorizuar i Klubit të këshilltarëve, nëse Klubi i tij, partia e tij politike ose koalicioni përmendet në një kontekst negativ.

Të drejtë në replikë ka edhe propozuesi, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit të aktit mbi të cilin zhvillohet debati, si edhe pjesëmarrësi tjetër në punë të kuvendit.

Të drejtë në replikë ka kryetari i Komunës, gjegjësisht përfaqësuesi i kryetarit të Komunës, nëse në kontekst negativ është përmendur kryetari i Komunës, gjegjësisht organi i administratës lokale ose shërbimi publik themelues i të cilit është Komuna.

E drejta nga paragrafi 1,2,3 dhe 4 i këtij neni mund të shfrytëzohet vetëm njëherë në kohëzgjatje prej 3 minuta.

Replika në replikë nuk është e lejuar, përveç nëse kryetari i Kuvendit e vlerëson se deklarinimet në replikë janë ofenduese dhe e lejon atë replikë.

### **Neni 89**

Kur të konstatojë se nuk ka të tjerë të lajmëruar për pjesëmarrje në diskutim, kryetari i Kuvendit e mbyll diskutimin.

## **Pauza në punën e seancës**

### **Neni 90**

Kryetari i Kuvendit mund të përcaktojë pauzën nëse atë e kërkojnë rrethanat në punën e kuvendit.

Kryetari i Kuvendit me kërkesë të Klubit të këshilltarëve mund të caktojë pauzë që të bëhen konsultimet dhe të merren mendimet e nevojshme mbi çështjen e caktuar.

Pauza nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjasë jo më gjatë se 30 minuta.

## **Mbajtja e rëndit në seancë**

### **Neni 91**

Për rëndin në seancë kujdeset kryetari i Kuvendit.

Këshilltarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në diskutim janë të obliguar që të respektojnë reputacionin e Kuvendit, këshilltarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, që njëri tjetrit t'i drejtohen me edukatë dhe respekt.

Nuk është i lejuar përdorimi i shprehjeve ofenduese, të dhënave personale, ose vlerësimeve nga jeta private e këshilltarit dhe personave të tjerë.

Adresimi i këshilltarëve bëhet vetëm me emër dhe mbiemër.

## **Masat për ruajtjen e rendit**

### **Neni 92**

Për prishjen e rendit në seancë mund të shqiptohen masat: vërejtje, marrja e fjalës dhe largim nga seanca.

Masën e vërejtjes dhe të marrjes së fjalës e shqipton kryetari i Kuvendit.

Mbi masën e largimit të këshilltarit nga seanca, vendosë Kuvendi me propozim të kryetarit të Kuvendit, pa diskutim.

Masat e shqiptuara shënohen në procesverbalin e seancës.

### **Neni 93**

Masa e vërejtjes i tërhiqet këshilltarit nëse:

- Flet para se ta kërkojë dhe fitojë të drejtën e fjalës;
- Me gjithë paralajmërimin e kryetarit të Kuvendit flet mbi çështje që nuk janë në rend të ditës;
- Ndërpret folësin gjatë fjalës ose i ndërhyjnë, gjegjësisht pengon folësin ose në mënyra të tjera rrezikon lirinë e fjalës;
- Merret me fakte që kanë të bëjnë me jetën private të këshilltarëve ose personave të tjerë dhe
- Me veprime të tjera prish rendin dhe qetësinë në seancë ose vepron kundër rregullave të kësaj rregullore.

### **Neni 94**

Masa e marrjes së fjalës i tërhiqet këshilltarit të cilit paraprakisht dy herë i është tërhequr vërejtja, e i cili përsëri vazhdon të prish rendin në seancë ose vepron kundër rregullave të kësaj Rregullore.

Këshilltarit të cilit i është tërhequr vërejtja e marrjes së fjalës është i obliguar që ta ndërpresë fjalën e vet, në të kundërtën, kryetari i Kuvendit e ndalë zerimin dhe sipas nevojës, cakton pauzën.

### **Neni 95**

Masa e largimit nga seanca i shqiptohet këshilltarit i cili, pas tërheqjes së vërejtjes së marrjes së fjalës, pengon ose parandalon punën në kuvend, nuk e respekton vendimin e kryetarit të Kuvendit mbi tërheqjen e vërejtjes së marrjes së fjalës ose vazhdon me prishjen e rendit në seancë.

Masa e largimit nga seanca mund t'i shqiptohet këshilltarit edhe pa shqiptimin e masave paraprake, në rast të prishjes së rendit ose sulmit fizik ndaj këshilltarëve ose personave të tjerë në ndërtesën e Komunës.

Këshilltarit të cilit i është shqiptuar masa e largimit nga seanca është i obliguar që menjëherë të largohet nga seanca.

Nëse këshilltari refuzon që të largohet nga seanca, kryetari i Kuvendit do t'u urdhërojë personave përgjegjës për mbajtjen e rendit në ndërtesën e Komunës që atë këshilltarë ta largojë nga seanca.

Nëse kryetari i Kuvendit me masat e marra nuk mund të sigurojë rendin në seancë, do të caktojë pushim, deri sa ta vendosë rendin.

Dispozitat mbi mbajtjen e rendit në seancën e Kuvendit, njëjtë zbatohen edhe gjatë punës së trupave punues të Kuvendit.

Dispozitat mbi mbajtjen e rendit në seancën, njëjtë zbatohen edhe për pjesëmarrësit e tjerë në punën e Kuvendit.

## **Vendimmarrja**

### **Neni 96**

Kuvendi vendos nëse në seancë marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve, ndërsa vendimet i sjellë me shumicë votash të këshilltarëve prezent, nëse me Statut të Komunës nuk është paraparë ndryshe.

Kuvendi vendos mbi secilën çështje e cila është e vendosur në rend të ditës, sipas rregullit pas përfundimit të diskutimit.

### **Neni 97**

Kuvendi vendos me votim të hapur, përveç nëse me Statut ose këtë Rregullore nuk është paraparë që për çështje të caktuara të vendoset me votim të fshehtë.

### **Neni 98**

Para se të votohet, kryetari i Kuvendit e përcakton nëse ka kuorum dhe i thërret këshilltarët të marrin pjesë në votim.

Votimi i hapur bëhet përmes sistemit elektronik të votimit, me ngritje të dorës ose me deklaram.

Votimi me ngritje të dorës bëhet vetëm nëse sistemi për votim elektronik nuk është në funksion.

Votimi me deklaram bëhet kur këtë e përcakton kryetari i Kuvendit ose me kërkesë të 10 këshilltarëve.

Këshilltari voton duke u deklaruar “për”, “kundër” ose “i përmbajtur”.

### **Neni 99**

Numërimin e votave e bën sekretari i Kuvendit ose personi të cilin ai e përcakton.

Pas përfundimit të votimit kryetari i Kuvendit e konfirmon rezultatin e votimit dhe e shpall nëse propozimi është miratuar apo nuk është miratuar.

### **Neni 100**

Kuvendi mund të vendos që votimi të jetë i fshehtë.

Votimi i fshehtë bëhet me fletëvotime të cilat shtypen në po atë numër sa ka edhe këshilltarë.

Fletëvotimet janë të madhësisë, formës dhe ngjyrës së njëjtë dhe janë të vërtetuar me vulën e Kuvendit.

Për çdo përsëritje të votimeve në fletëvotime shënohet shenja e atij votimi ose fletëvotimet shtypen në ngjyrë tjetër.

Për shtypjen dhe vulosjen e fletëvotimeve është përgjegjës sekretari i Kuvendit.

#### **Neni 101**

Nëse votohet fshehtë mbi propozimin e aktit, fletëvotimi përmban emrin e atij akti, e nën emër në anën e majtë fjalën “për”, e në anë të djathtë fjalën “kundër”.

Këshilltari voton duke rrumbullaksuar fjalën “për” ose fjalën “kundër”.

#### **Neni 102**

Gjatë votimit për zgjedhje ose emërimë, fletëvotimi përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit sipas rendit alfabetik të mbiemrave, e përpara mbiemrave të secilit kandidat vendoset numri rendor.

Votimi bëhet me rrumbullaksim të numrit rendor të kandidatit për të cilin këshilltari voton.

Nëse në fletëvotim ka më shumë kandidatë nga numri i atyre që zgjedhën, mund të votohet për aq kandidat sa edhe zgjedhën.

Nëse në fletëvotim është vetëm një kandidat mbi të cilin vendoset, fletëvotimi përmban fjalët “për” dhe “kundër” dhe votohet me rrumbullaksim të fjalës “për” ose “kundër”.

#### **Neni 103**

Me votim të fshehtë udhëheqë Komisioni tre anëtarësh, të cilit në punë i ndihmon sekretari i Kuvendit.

Përbërja e Komisionit i përgjigjet përfaqësimit partiak në Kuvend.

Komisionin nga paragrafi 1 i këtij neni e zgjedhë Kuvendi, me propozim të kryetarit të Kuvendit, gjegjësisht udhëheqësit të Kuvendit.

#### **Neni 104**

Para fillimit të votimit, kryetari i Kuvendit përkatësisht udhëheqësi jep sqarimet e nevojshme mbi mënyrën e votimit dhe cakton kohën e pushimit për konfirmimin e rezultateve të votimit.

#### **Neni 105**

Sekretari i Kuvendit bën thirrjen, i dorëzon këshilltarit fletën e votimit dhe i evidenton këshilltarët të cilët e kanë marrë fletëvotimin.

Pasi që voton, këshilltari personalisht e vendos fletëvotimin e palosur në kutinë e votimit.

#### **Neni 106**

Pas përfundimit të votimit Komisioni për votim, i qaset përcaktimit të rezultateve të votimit, në të njëjtën hapësirë në të cilën është kryer votimi.

Para hapjes së kutisë së votimit, përcaktohet numri i fletëvotimeve të padorëzuara.

#### **Neni 107**

Komisioni për votim harton raportin mbi rezultatet e votimit të fshehtë i cili përmban: numrin e fletëvotimeve të dorëzuara,; numrin e fletëvotimeve të papërdorura; numrin e fletëvotimeve të gjendura në kutinë e votimit; numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme; numrin e votave “pro” dhe “kundër”, gjegjësisht numrin e votave për secilin kandidat; si dhe konstatimin se a është pranuar propozimi, gjegjësisht cili kandidat është zgjedhur.

### **Neni 108**

Fletëvotimi trajtohet si i pavlefshëm nëse: është i paplotësuar, është i plotësuar në atë mënyrë që nuk mund të konstatohet saktë se si ka votuar këshilltari, si dhe kur në fletëvotim janë rrumbullaksuar më shumë kandidat se sa zgjedhën.

### **Neni 109**

Pas përfundimit të votimit, kryetari i Kuvendit, gjegjësisht udhëheqësi shpall rezultatin e votimit dhe zgjedhjen e bërë.

Rinumërimi i votave mbi të njëjtën çështje mund të përsëritet vetëm njëherë.

Rezultati i votimeve shënohet në procesverbal.

### **Procesverbali**

### **Neni 110**

Mbi punën e seancës së Kuvendit hartohet procesverbali.

Në procesverbal shënohen emrat e këshilltarëve të cilët nuk kanë marrë pjesë në seancë, të dhënat themelore mbi punën, pjesëmarrësit në diskutim, aktet e sjella sipas pikave të veçanta dhe emrat e akteve të cilat i ka sjellë Kuvendi në seancë në lidhje me pikat e rëndit të ditës.

Në procesverbal shënohen dhe rezultatet e votimit mbi akte të posaçme.

Me kërkesë të këshilltarëve në procesverbal shënohet edhe mendimi personal i këshilltarit.

Në procesverbal shënohet përmbajtja e shkurtër e pyetjeve të këshilltarëve dhe përgjigjia në pyetjen e këshilltarit.

### **Neni 111**

Për hartimin e procesverbalit përkujdeset sekretari i Kuvendit.

Procesverbali u dorëzohet këshilltarëve bashkë me thirrjen për seancën e ardhshme.

Këshilltari ka të drejtë që para miratimit të procesverbalit të bëjë vërejtjet në procesverbal.

Procesverbalin e miratuar e nënshkruajn kryetari i Kuvendit dhe sekretari i Kuvendit.

Në seancën e Kuvendit bëhet inçizimi tonik.

Në bazë të inçizimit tonik bëhet edhe hartimi i procesverbalit.

Inçizimi tonik dhe procesverbali ruhen në dokumentacionin e Kuvendit.

Këshilltari ka të drejtë të ketë qasje në incizimin tonik dhe në procesverbal.

Mënyra e hartimit, përdorimit, seleksionimit dhe ruajtjes së materialeve tonike dhe procesverbaleve nga seanca e Kuvendit, rregullohet me akt të veçantë të sekretarit, me pëlqim të kryetarit të Kuvendit.

## **VII AKTET E KUVENDIT DHE PROCEDURA PËR SJELLJEN E TYRE**

### **Aktet e Kuvendit**

### **Neni 112**

Kuvendi, në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta sjellë: Statutin, vendimet, planet, aktvendimet, përfundimet, kartat, rekomandimet dhe aktet e tjera, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

## **Procedura për sjelljen e vendimeve**

### **Neni 113**

Të drejtë propozimi të vendimeve, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme kanë kryetari i Komunës, këshilltari dhe së paku 2% e qytetarë të regjistruar në regjistrin zgjedhor me vendqëndrim në territorin e Komunës.

Propozuesi i vendimit përcakton përfaqësuesin gjatë shqyrtimit të propozimit të vendimit në Kuvend dhe në trupat punuese.

### **Neni 114**

Procedura për sjelljen e vendimit inicohet me dorëzimin e propozim vendimit.

Propozim vendimi dorëzohet në kopje të mjaftueshme, në gjuhën malazeze dhe shqipe.

Përfundimisht në rastet kur propozues është trupi punues, këshilltari ose grupi i qytetarëve, përkthimin dhe fotokopjimin e materialit e siguron Shërbimi i kuvendit.

Propozim vendimi dorëzohet në formën që vendimi miratohet dhe duhet të jetë i arsyetuar.

Arsyetimi përmban: bazën juridike për sjelljen e vendimit, arsyet për sjelljen dhe vlerësimin e mjeteve financiare të nevojshme për zbatimin e vendimit.

Nëse me propozim vendimin krijohen detyrime për buxhetin e Komunës, në arsyetim shënohet vlerësimi i mjeteve për zbatimin e tij dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

Raportet, Programet dhe materialet e tjera të Shërbimeve publike e të cilat i shqyrton Kuvendi, Kryetari i komunës ja dorëzon Kuvendit së bashku me mendimin e organit të administratës lokale i cili ushtron mbikëqyrjen mbi punën e tyre.

Nëse propozim vendimi nuk është hartuar dhe dorëzuar në pajtim me këtë Rregullore, kryetari i Kuvendit do të kërkojë nga propozuesi që propozim vendimin, në afat prej 8 ditësh, ta përgatisë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore.

Nëse propozuesi i vendimit nuk e përgatit propozim vendimin në pajtim me paragrafin e mëparshëm, do të konsiderohet sikur propozim vendimi nuk është dorëzuar fare.

### **Neni 115**

Bashkë me propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit dorëzohet edhe teksti themelor i vendimit ndryshimi i të cilit propozohet.

Propozim vendimi i dorëzohet kryetarit të Komunës me qëllim të dhënies së mendimit, kur ai nuk është propozues.

Kryetari i Komunës jep mendim mbi propozim vendimin, para shqyrtimit të tij nga trupat punues.

Kur me propozim vendim rregullohen çështje të rëndësishme, propozuesi i vendimit mund të propozojë që Kuvendi ta konfirmoj draftin, ta vendos në shqyrtim publik dhe të caktoj organin kompetent për realizimin e shqyrtimit publik.

Mbi konfirmimin e propozimit Kuvendi vendos me Përfundim.

### **Neni 116**

Para shqyrtimit të propozim vendimit në seancën e Kuvendit, propozim vendimin e shqyrton trupi punuese në fushëveprimin e të cilit është çështja e cila rregullohet me vendim dhe Këshilli për statut dhe dispozita.

Propozim vendimin mund ta shqyrtojnë edhe trupa të tjera punuese nëse me propozim janë të përfshira ose kanë ndikim në fushat nga kompetencat e atyre grupeve punuese.

### **Neni 117**

Sipas shqyrtimit të propozim vendimit, trupi punues kompetent në raportin e vet i propozon Kuvendit që propozim vendimi të miratohet ose të mos miratohet.

Trupi punues kompetent me parashtrimin e amendamentit mundet t'i propozojë Kuvendit që propozim vendimin ta miratojë në tekstin e ndryshuar në raport me tekstin të cilin e ka dorëzuar propozuesi.

Raporti i trupit punues u dorëzohet këshilltarëve dhe propozuesit të vendimit, sipas rregullit, para fillimit të punës së seancës së Kuvendit.

### **Shqyrtimi i propozim vendimit**

### **Neni 118**

Mbi propozim vendimin në seancë të Kuvendit, mbahet diskutim.

Nëse në diskutim është dhënë numër i rëndësishëm i propozimeve për ndryshimin e aktvendimeve të veçanta dhe kur ne propozim vendim është dhënë numër i madh i amendamenteve të cilat propozuesi nuk i ka pranuar, Kuvendi mund në propozim të kryetarit të Kuvendit ose me kërkesë të propozuesit, të vendos për shtyrjen e votimit mbi propozim vendimin, në mënyre që propozuesi dhe trupat punuese kompetente përsëri të shqyrtojnë propozimin e vendimit dhe të marrin qëndrime mbi vërejtjet dhe propozimet e dhëna, t'i përshtasin amendamentet me tekstin e propozimit të vendimit dhe t'ia dorëzojnë Kuvendit propozimin përfundimtar.

Me përfundimin e diskutimit dhe votimit mbi amendamentet i qaset votimit mbi propozimin në tërësi.

Propozuesi i vendimit mund ta tërheqë propozim vendimin deri në përfundim të diskutimit mbi atë propozim vendim.

### **Amendamentet**

### **Neni 119**

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e propozim vendimit i dorëzohet kryetarit të Kuvendit si amendament në formë të shkruar dhe duhet të jetë i arsyetuar.

Amendamentin mund ta dorëzojnë propozuesit e autorizuar për dorëzimin e propozim vendimeve dhe trupi punues kompetent i Kuvendit.

Dorëzuesi i amendamentit është i obliguar që në arsyetim të amendamentit të paraqesë nëse për realizimin e amendamentit është e nevojshme të sigurohen mjete shtesë financiare.

Amendamenti dorëzohet jo më vonë se tre ditë para fillimit të seancës në të cilën shqyrtohet propozim vendimi.

Propozuesi i vendimit, kryetari i Komunës nëse nuk është propozues i vendimit dhe trupi punues kompetent mund ta dorëzojnë amendamentin në formë të shkruar me arsyetim deri në përfundim të diskutimit mbi propozim vendimin.

### **Neni 120**

Amendamenti në propozimin e vendimit u drejtohet këshilltarëve, propozuesit, kryetarit të Komunës nëse ai nuk është propozues dhe trupit punues përkatës nëse ai nuk është propozues i amendamentit.

Propozuesi i vendimit dhe kryetari i Komunës nëse nuk është propozues i vendimit, i dorëzojnë Kuvendit sqarimin për secilin amendament të dorëzuar në formë të shkruar.



Trupi punues kompetent është i obliguar që ti shqyrtojë amendamentet të cilët janë dorëzuar në propozim të vendimit dhe ti propozojë Kuvendit se cilat amendamente t'i pranojë, e cilat t'i refuzojë.

#### **Neni 121**

Kuvendi vendos mbi amendamentet sipas renditjes së neneve të propozim vendimit në të cilin janë të paraqitur.

Nëse në të njëjtin nen të propozim vendimit janë dorëzuar më shumë se një amendamente, së pari vendoset mbi amendamentin me të cilin propozohet fshirja e atij neni, e pastaj mbi amendamentet të cilat propozojnë ndryshimet e atij neni.

Nëse është ngritur amendament mbi amendament, fillimisht votohet mbi amendamentin i cili është ngritur mbi amendament.

Amendamenti të cilin e ka ngritur propozuesi i vendimit dhe amendamenti të cilin propozuesi i vendimit e ka pranuar bëhet pjesë përbërëse e propozim vendimit dhe mbi të veçanërisht nuk vendos Kuvendi.

#### **Sjellja e akteve me procedurë të shkurtuar (emergjente).**

#### **Neni 122**

Përrjashtimisht, vendimi mund të nxirret me procedurë emergjente.

Me procedurë emergjente mund të nxirren vetëm vendimet me të cilat rregullohen çështje dhe marrëdhënie, për rregullimin e të cilave ekziston nevoja e pashmangshme, ndërsa mosnxjerrja e tyre do të mund të shkaktonte pasoja të dëmshme.

Propozuesi i aktit është i obliguar që në arsyetim të propozim vendimit të shënojë arsyet për të cilat është e nevojshme që vendimi të nxirret me procedurë emergjente.

#### **Neni 123**

Propozimi vendimi për sjelljen e të cilës propozohet procedura emergjente mund të vendoset në rend të ditës së seancës së Kuvendit, nëse është dorëzuar 24 orë para fillimit të seancës.

Nëse Kuvendi e pranon propozimin që vendimi të sillet me procedurë emergjente, caktohet afati në të cilin trupat punuese do të shqyrtojnë propozim vendimin dhe të dorëzojnë raportin, si dhe afatin në të cilin kryetari i Komunës, nëse nuk është propozues i vendimit, t'i japë mendimin Kuvendit mbi propozim vendimin.

#### **Neni 124**

Kur trupi punues kompetent ta shqyrtojë propozim vendimin për sjelljen e të cilit është vendosur procedura emergjente, Kuvendi mund të vendosë që diskutimi mbi propozim vendimin të fillojë menjëherë edhe pa raport të shkruar, me ç rast raportuesi do ta paraqesë gojarisht në kuvend.

Nëse trupi punuese kompetente nuk e dorëzon raportin brenda afatit të caktuar, diskutimi mbi propozim vendimin mund të bëhet në Kuvend edhe pa raportin e trupit punues.

Amendamentet në propozim vendimin i cili nxirret me procedurë emergjente mund të dorëzohen deri në përfundim të shqyrtimit.

Mbi amendamentet deklarohen trupat punuese përkatëse dhe kryetari i Komunës, nëse nuk është propozues.

## **Procedura për sjelljen e akteve të tjera**

### **Neni 125**

Sjellja e akteve të tjera kryhet në mënyrë dhe me procedurë të paraparë për sjelljen e vendimeve, vetëm nëse me Rregullore të punës nuk është përcaktuar ndryshe.

Propozimi që të bëhet ndryshimi apo plotësimi i propozimit të aktit i cili për shkak të natyrës së vet nuk mund të silltet në formën e amendamentit, dorëzohet si propozim për ndryshim, gjegjësisht plotësim, bashkë me arsyetimin.

Në propozimet e akteve të veçanta nuk mund të dorëzohen amendamente, as propozimet për ndryshimin e tyre, gjegjësisht plotësimin.

Bashkë me propozimin e projektit urbanistik dhe dokumenteve të tjera lokale planifikuese, këshilltarëve u dorëzohet lajmërimi se në ç mënyrë dhe ku mund ti shikojnë të njëjtat.

Bashkë me propozimin e dokumenteve nga paragrafi më lartë, propozim Vendimit mbi buxhetin e Komunës dhe vendimeve të tjera me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, dorëzohet raporti mbi shqyrtimin publik të realizuar, e bashkë me Llogarinë përfundimtare të buxhetit raporti i revizionit ekstern.

Bashkë me propozimin e aktit dorëzohet edhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm në pajtim me Ligjin, Statutin dhe vendimin e Kuvendit.

## **Procedimi sipas iniciativës qytetare**

### **Neni 126**

Qytetarët, organeve të Komunës mund t'i drejtojnë iniciativë qytetare për sjellje ose ndryshim të aktit me të cilin rregullohen çështje me rëndësi nga kompetencat e Komunës, në pajtim me Statutin e Komunës.

Iniciativa qytetare me të cilën kërkohet sjellja ose ndryshimi i akteve të Kuvendit i dorëzohet kryetarit të Komunës, trupit punuese kompetente të Kuvendit dhe organit të administratës lokale me qëllim të dhënies së mendimit.

Organet nga paragrafi 2 i këtij neni janë të obliguar që të japin mendimin mbi iniciativën e dorëzuar qytetare në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të saj.

### **Neni 127**

Mbi iniciativën qytetare Kuvendi vendos me përfundim.

Me përfundimin mbi pranimin e iniciativës, Kuvendi përcakton afatin në të cilin organi kompetent është i obliguar të përgatisë propozimin e aktit me të cilin rregullohet çështja që është përfshirë në iniciativë.

Në procedurën e përgatitjes dhe përpunimit të aktit sipas iniciativës qytetare, organi kompetent është i obliguar që të përfshijë parashtruesin e iniciativës qytetare.

Përderisa nuk e pranon iniciativën, Kuvendi mund të vendosë që mbi atë çështje të shpallë referendum, në afat prej 90 ditësh nga dita e sjelljes së përfundimit.

## **Procedura sipas kërkesës ose propozimit të Forumit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale**

### **Neni 128**

Kuvendi, në afat prej 60 ditësh shqyrton dhe deklarohe, sipas kërkesës ose propozimit të Forumit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale.

Në seancën në të cilën Kuvendi deklarohet mbi kërkesën ose propozimin e Forumit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale, kryetari i Forumit merr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit të propozuesit të aktit.

Propozim akti të cilin e ka dorëzuar Forumi për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale, para shqyrtimit në Kuvend, i dorëzohet kryetarit të Komunës dhe trupës punuese kompetente, me qëllim të dhënies së mendimit.

### **Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit**

#### **Neni 129**

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës kryhen me procedurë dhe në mënyrë të paraparë në Statutin e Komunës.

Procedura për ndryshime dhe plotësime të Statutit inicohet me propozim vendimin mbi qasjen në ndryshime dhe plotësime të Statutit.

#### **Neni 130**

Propozim vendimi mbi qasjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit, kryetari i Kuvendit ia drejton këshilltarëve, trupës punuese kompetente dhe kryetarit të Komunës, nëse ai nuk është propozues.

#### **Neni 131**

Mbi propozim vendimin mbi qasjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit zhvillohet diskutim. Me përfundim të diskutimit, Kuvendi vendos nëse pranohet propozimi i vendimit.

#### **Neni 132**

Kur të pranohet propozimi i Vendimit mbi qasjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës, Kuvendi themelon Komisionin për hartimin e propozim vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës dhe cakton afatin në të cilin Komisioni është i obliguar që të përgatisë propozim vendimin dhe të njëjtin t'ia dorëzojë Kuvendit.

#### **Neni 133**

Procedura për sjelljen e Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës është identike si për sjelljen e Statutit.

Mbi sjelljen e Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Komunës, Kuvendi vendos me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

## **VIII PROCEDURA PËR ZGJEDHJE, EMËRIME DHE SHKARKIME**

#### **Neni 134**

Në procedurën e zgjedhjes dhe shkarkimit të kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Komunës dhe emërimit dhe shkarkimit të sekretarit të Kuvendit, aplikohen dispozitat e ligjit dhe Statutit të Komunës.

#### **Neni 135**

Kryetari i Komunës ia dorëzon Kuvendit aktin mbi emërimin, përkatësisht shkarkimin e nënkryetarit të Komunës, me propozim për dhënien e pëlqimit në aktin e emërimit, gjegjësisht shkarkimit.

Propozimi i aktit të kryetarit të Komunës mbi shkarkimin e nënkryetarit të Komunës, para seancës së Kuvendit, i dorëzohet nënkryetarit të Komunës me qëllim të informimit dhe sqarimit.

Mbi propozimin për emërim, gjegjësisht shkarkim hapet diskutimi.

Nënkryetari i Komunës ka të drejtë që në seancën e Kuvendit të sqarojë mbi arsyet e paraqitura për shkarkim.

Pas përfundimit të diskutimit, Kuvendi vendos mbi dhënien e pëlqimit në aktin mbi emërimin, gjegjësisht shkarkimin e nënkryetarit të Komunës.

## **IX DORËHEQJA**

### **Neni 136**

Kryetari i Kuvendit dhe kryetari i Komunës dorëheqjen i'a dorëzojnë Kuvendit në formë të shkruar.

Kuvendi në seancën e parë të radhës njofton mbi dhënien e dorëheqjes dhe konstaton ndërprerjen e mandatit, pa shqyrtim.

Nënkryetari i Kuvendit dhe sekretari i Kuvendit dorëheqjen ia dorëzojnë kryetarit të Kuvendit në formë të shkruar.

Nënkryetari i Komunës dorëheqjen i'a dorëzon kryetarit të Komunës në formë të shkruar.

Mbi dorëheqjen e dhënë nga personat nga paragrafi 3 dhe 4 kryetari i Kuvendit, gjegjësisht kryetari i Komunës e lajmërojnë Kuvendin.

## **X PROCEDURA PËR PËRCJELLJEN E REALIZIMIT TË LIGJEVE, DISPOZITAVE DHE AKTEVE TË TJERA**

### **Neni 137**

Me qëllim të përcjelljes së gjendjes në fusha të veçanta, ekzekutimin e ligjeve, dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme dhe detyrimeve të organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike, Kuvendi, së paku një herë në vit shqyrton raportin mbi punën e kryetarit të Komunës dhe punën e organeve të administratës lokale dhe raportin e shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna.

Kuvendi i shqyrton raportet, analizat, informacionet dhe materialet e tjera analitike të cilat i përgatisin organet e administratës lokale dhe shërbimet publike.

### **Neni 138**

Me rastin e shqyrtimit të materialit nga neni paraprak, Kuvendi mund:

- të sjellë përfundim mbi pranimin e tyre;
- të sjellë përfundim me të cilin obligon dorëzuesin të plotësojë raportin mbi çështje të caktuara;
- të sjellë përfundim me të cilin përcaktohen detyrimet e caktuara të organit kompetent, gjegjësisht shërbimit publik dhe tu jap udhëzime për punën e mëtejshme;
- të japë iniciativë për ndërmarrje të përgjegjësisë ose të propozojë masa të përgjegjësisë ndaj personit përgjegjës për shkak të moszbatimit të vendimit, dispozitave të tjera ose aktit të përgjithshëm nga kompetencat e Kuvendit;
- të japë iniciativën organeve kompetente shtetërore me qëllim të ndërmarrjes së masave përkatëse.

### **Neni 139**

Në procesin e përgatitjes dhe sjelljes së planeve, programit të punës dhe zhvillimit të shërbimeve publike dhe personave të tjerë juridik, themelues i të cilave është shteti, e të cilët funksionin e realizojnë në territorin e Komunës, Kuvendi i shqyrton projektvendimet e këtyre akteve, jep propozime për avancimin e tyre dhe përcjellë realizimin e tyre.

Shërbimet publike dhe personat juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar që Kuvendit me kërkesë të tij t'i dorëzojnë Raportin mbi punën dhe realizimin e planeve dhe programeve nga kompetencat e tyre në territorin e Komunës.

## **XI BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME PARLAMENTIN E MALIT TË ZI, KUVENDET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE DHE BASHKËSIVE LOKALE TË SHTETEVE TË TJERA**

### **Neni 140**

Kuvendi dhe trupat e tij punues bashkëpunojnë me Parlamentin e Malit të Zi dhe me kuvendet e njësisve të vetëqeverisjeve lokale në Mal të Zi si dhe me trupat punues të tyre, shkëmbejnë informacione, përvoja dhe shembuj të praktikës së mirëfilltë, dokumentacionet dhe materiale të tjera, vizita të ndërsjellta të përfaqësuesve të kuvendit dhe trupave të tyre punues dhe përmes formave të tjera të bashkëpunimit të ndërsjelltë.

Përveç bashkëpunimit me subjektet nga paragrafi paraprak, Kuvendi bashkëpunon edhe me bashkësinë e komunave të Malit të Zi, me bashkësitë lokale të shteteve të tjera dhe asociacionet e tyre.

## **XII PUNA PUBLIKE E KUVENDIT**

### **Neni 141**

Puna e Kuvendit është publike.

Mediet elektronike kanë të drejtë që të transmetojnë drejtpërsëdrejti seancën e Kuvendit.

Kuvendi siguron kushtet që mediet elektronike mund të kryejnë transmetimin e seancës së Kuvendit, për të cilën gjë përkujdeset sekretari i Kuvendit.

Kuvendi dhe trupat e tij punues do të përjashtojnë publikun nga puna e vet në rastet kur shqyrtohen materiale, fshehtësia e të cilave është përcaktuar me ligj.

Propozimi që seanca të mbyllet për publikun në rastet e parapara me paragrafin 4 të këtij neni, mund ta dorëzojë kryetari i Kuvendit, kryetari i Komunës ose më së paku 1/3 e këshilltarëve.

Mbi propozimin nga paragrafi 5 i këtij neni Kuvendi vendos me shumicë votash të këshilltarëve prezent.

### **Neni 142**

Kuvendi informon publikun mbi punën e vet, temat mbi të cilat diskutohet dhe vendimet të cilat i sjellë.

Propozimet e caktuara të akteve mbi të cilat diskutohet mund të publikohen në mjetet e informimit publik ose në publikim të veçantë për të cilën gjë Kuvendi sjell vendim.

### **Neni 143**

Përfaqësuesve të autorizuar të informimit publik u vihet në përdorim propozimi i akteve dhe materiale të tjera të cilat shqyrtohen në Kuvend dhe në trupat e tij punues, përveç nëse me akt të përgjithshëm

mbi mënyrën e përdorimit të materialit në Kuvend i cili trajtohet si i natyrës së fshehtë nuk është e përcaktuar ndryshe.

Kuvendi përfaqësuesve të medieve ua mundëson kushtet e nevojshme për përcjelljen e seancave të Kuvendit dhe trupave të tij punues.

Për arsye të sigurimit të informimit më të mirë të publikut mbi punën e Kuvendit dhe trupave të tij punuese, Kuvendi publikon të dhëna dhe informacione mbi punën e vet dhe të trupave punuese në web faqen e Kuvendit dhe Biltenin e Kuvendit i cili parimisht botohet dy herë në vit.

#### **Neni 144**

Përfaqësuesi i autorizuar i Kuvendit mund të japë deklaratë zyrtare për media.

Tekstin e deklaratës zyrtare e aprovon kryetari i Kuvendit ose personi të cilin ai e autorizon.

Konferencën për media në Kuvend mund ta mbajë kryetari i Kuvendit, kryetari i klubit të këshilltarëve dhe kryetari i trupit punues.

#### **Neni 145**

Me qëllim të sigurimit të publikut dhe transparencës së punës së Kuvendit, kryetari i Kuvendit më së paku një herë në tre muaj me anë të medieve lokale ose në mënyrë tjetër të përshtatshme informon qytetarët mbi aktivitetet e Kuvendit në periudhën e kaluar dhe mbi aktivitetet e planifikuara në periudhën që vijon.

#### **Neni 146**

Mbi zbatimin e dispozitave të cilat kanë të bëjnë me punën publike të Kuvendit përkujdesen kryetari i Kuvendit dhe sekretari i Kuvendit.

### **XIII PROGRAMI I PUNËS SË KUVENDIT**

#### **Neni 147**

Kuvendi sjellë programin e punës për vitin kalendarik.

Me program të punës përcaktohen punët dhe detyrat e Kuvendit dhe përmbajtja e tyre themelore, bartësit e punës dhe afatet për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.

#### **Neni 148**

Në përgatitjen e programit të Punës së Kuvendit shërbimi i Kuvendit merr propozime dhe mendime mbi çështjet të cilat duhet t'i rendisë në programin e punës nga kryetari i Komunës, organet e administratës lokale, klubet e këshilltarëve, këshilltarët, trupat punuese, shërbimet publike, bashkësitë lokale dhe organizatat joqeveritare.

Kryetari i Kuvendit në kolegjum shqyrton propozimet e arritura dhe përcakton propozimin e programit të punës së Kuvendit për vitin kalendarik të cilin ia dorëzon Kuvendit në shqyrtim.

Kryetari i Kuvendit, kryetari i Komunës, klubi i këshilltarëve dhe trupi punues i Kuvendit mund të propozojnë që çështje të caktuara të futen në programin e punës së Kuvendit, më së largu tre ditë para mbajtjes së seancës, bashkë me arsyetimin e propozimit.

Mbi propozimet e dorëzuara për plotësim të programit të punës, Kuvendi vendos pa diskutim.

## **XIV PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE/QYTETARËVE**

### **Neni 149**

Përfaqësuesi i organizatave joqeveritare mund të marrë pjesë në seancën e Kuvendit në mënyrën dhe sipas procedurës së parashikuar me këtë Rregullore.

Për një pikë të rendit të ditës në seancë të Kuvendit mund të marrë pjesë një përfaqësues i organizatave joqeveritare.

### **Neni 150**

Përfaqësuesi i organizatës joqeveritare mund të marrë pjesë në punën e seancës së Kuvendit (Instituti “ulësja e lirë”) përderisa organizata joqeveritare plotëson kushtet si në vijim:

- të jetë e regjistruar së paku një vit;
- të ketë selinë brenda territorit të Komunës;
- që në vitin e kaluar të ketë realizuar një ose më shumë projekte në Komunë, ose marrë pjesë në më së paku një fushatë publike në Komunë, ose realizuar më së paku dy aksione me rëndësi për Komunën, ose ka marrë pjesë me propozime konkrete në më së paku tre shqyrtime publike të cilat janë realizuar në Komunë;
- që në Statut ka veprimtari të caktuara dhe qëllime të veprimit për fushën e caktuar dhe
- të ketë anëtarët të cilët posedojnë përvojë dhe njohin temën e caktuar, ose ka bashkëpunëtorë të cilët posedojnë referenca profesionale sipas temave të caktuara.

Organizata joqeveritare e cila plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni ka të drejtë të propozojë, gjegjësisht emërojë përfaqësuesin e organizatës joqeveritare i cili do të marrë pjesë në punën e seancës.

### **Neni 151**

Organizata joqeveritare është e obliguar që, për arsye të përdorimit të Institutit “ulësja e lirë”, shërbimit të Kuvendit t’i dorëzojë:

- fletëparaqitjen për pjesëmarrje në punën e Kuvendit të nënshkruar nga ana e personit i cili është i autorizuar të përfaqësojë ose prezantoj organizatën joqeveritare, me dokumentacionin në bazë të së cilit përcaktohet përmbushja e kushteve nga neni paraprak;
- Statutin e organizatës joqeveritare;
- Vendimin mbi themelimin e organizatës joqeveritare;
- Deklaratën e personit të autorizuar për përfaqësim ose prezantim të organizatës joqeveritare që në organin e udhëheqjes nuk ka anëtarë të organeve të partive politike dhe funksionar publik, në kuptim të dispozitave mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

### **Neni 152**

Shërbimi i Kuvendit në bazë të fletëparaqitjeve të dorëzuara të organizatave joqeveritare, themelon, udhëheqë dhe përditëson evidencën mbi organizatat joqeveritare të cilat i plotësojnë kushtet nga neni 150 i kësaj Rregulloreje.

### **Neni 153**

Thirrja organizatave joqeveritare për paraqitjen e pjesëmarrjes në seancë të Kuvendit publikohet në web-faqen e Kuvendit, më së largu 10 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit.

Thirrja organizatave për paraqitjen e pjesëmarrjes në seancë mund të bëhet edhe përmes emetuesit publik lokal si dhe në mënyrë tjetër.

Paraqitjen për pjesëmarrje në seancë të Kuvendit, organizatat joqeveritare i'a dorëzojnë kryetarit të Kuvendit më së largu shtatë ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit, ashtu që janë të obliguara që të shënojnë pikat e rëndit të ditës për të cilat paraqesin pjesëmarrjen në seancë.

#### **Neni 154**

Në rast se, për të njëjtën pikë të rëndit të ditës paraqiten disa organizata joqeveritare, kryetari i Kuvendit i fton në takim përfaqësuesit e atyre organizatave joqeveritare.

Në takim tek kryetari i Kuvendit, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare bëjnë marrëveshje dhe përcaktojnë përfaqësuesit të cilët do të marrin pjesë në punën e seancës sipas pikave të caktuara të rëndit të ditës.

#### **Neni 155**

Përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të cilët janë të caktuar të marrin pjesë në punën e seancës, u dorëzohet thirrja për seancë me materialin për pikën e rëndit të ditës sipas të cilës marrin pjesë, më së largu pesë ditë para mbajtjes së seancës.

Lajmërimi mbi përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët do të marrin pjesë në seancë të Kuvendit sipas pikave të caktuara të rëndit të ditës, publikohet në web faqen e Kuvendit.

#### **Neni 156**

Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët janë të ftuar të marrin pjesë në punën e seancës mund të paraqesin propozime dhe mendime në raport me materialet sipas pikave të rëndit të ditës për të cilat kanë kërkuar pjesëmarrjen më së largu tre ditë nga dita e mbajtjes së seancës.

Propozimet dhe mendimet i dorëzohen kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Komunës, ndonjë propozuesi tjetër të autorizuar dhe trupit punues kompetent.

Mbi propozimet dhe mendimet Kuvendi nuk vendos përveç kur i pranon propozuesi, gjegjësisht trupi punues kompetent, kur bëhen pjesë përbërëse e propozimit të propozuesit ose trupit punues.

#### **Neni 157**

Në punën e Kuvendit mund të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e qytetarëve të interesuar.

Qytetarët të cilët janë të interesuar që përfaqësuesi i tyre të marr pjesë në punën e Kuvendit, në formë të shkruar i parashtrojnë kërkesë kryetarit të Kuvendit, më së paku shtatë ditë para mbajtjes së seancës, me theksimin e çështjeve për të cilat janë të interesuar të marrin pjesë në seancë dhe caktimin e përfaqësuesit i cili do t'i përfaqësojë interesat e tyre në Kuvend.

Kryetari i Kuvendit, me rastin e vendosjes mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qytetarëve të interesuar në Kuvend, përkujdeset mbi mundësitë e hapësirës dhe nevojat e sigurimit të kushteve optimale për punë të seancës së Kuvendit.

#### **Neni 158**

Përfaqësuesit e qytetarëve të interesuar të cilët marrin pjesë në punën e seancës mund të dorëzojnë propozime dhe mendime, më së largu tre ditë para ditës së mbajtjes së seancës.

Propozimet dhe mendimet i dorëzohen kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Komunës, propozuesit tjetër të autorizuar dhe trupit punues kompetent.



Mbi propozimet dhe mendimet Kuvendi nuk vendos përveç kur i pranon propozuesi, gjegjësisht trupi kompetent punues, kur bëhen pjesë përbërëse e propozimit të propozuesit ose trupit punues.

#### **Neni 159**

Kryetari i Kuvendit më së paku një herë në vit organizon mbledhje të punës me përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe bashkësive lokale me qëllim të pasqyrimin të nivelit të bashkëpunimit dhe propozimeve për avancim.

### **XV SHËRBIMI I KUVENDIT**

#### **Neni 160**

Punët profesionale dhe punët e tjera për nevoja të Kuvendit, trupave punues të tij, kryetarit të Kuvendit, klubeve të këshilltarëve dhe këshilltarëve, organizatave joqeveritare dhe qytetarëve të cilët marrin pjesë në punën e seancës i kryen shërbimi i Kuvendit në pajtim me Vendimin mbi themelimin e Shërbimit të Kuvendit.

### **XVI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 161**

Procedura për sjelljen, gjegjësisht për ndryshimet dh plotësimet e Rregullores së punës inicohet me vendimin e Kuvendit.

Procedurën nga paragrafi 1 i këtij neni e zbaton komisioni i veçantë të cilin e emëron Kuvendi.

#### **Neni 162**

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlej Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit ( "Fletorja zyrtare e MZ- dispozitat komunale", numër 17/08 dhe 14/12 ).

#### **Neni 163**

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Fletoren zyrtare të MZ-dispozitat komunale".

Numër: 02 - 92/20 - 2

Ulqin, 27.05.2020

### **KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT**

Kryetari,  
Dr. Ilir Çapuni